

ITALO COSTANTE FORTINO

SHQYRTIME PËR VËMENDJEN E CAMAJT NDAJ KULTURËS ARBËRESHE

0 - Interesi i Camajt për kulturën arbëreshe

Duke lexuar revisten *Shêjzat*, të themeluar dhe praktikisht të drejtuar nga Prof. Ernest Koliqi¹, spikat nxënësi shoqërues besnik, Martin Camaj, i cili viziton, bashkë me Mjeshttrin, komunitetet arbëreshe² dhe shpejt bindet që është i nevojshëm studimi i varianteve dialektore arbëreshe, sepse kalimi i kohës, si një erë e ngadalshme por e papërmbajtëshme, mund të fshijë dukuri gjuhësore arkaike dhe deri në atë kohë akoma të gjalla³.

Përveç aspekteve shumë interesante që i perkasin antropologjisë, psikologjisë, kulturës folklorike, sociologjisë, Camaj, në komunitetet, ku ai shkon për t'i vizituar, rrok pasurinë më të gjallë dhe më të vlefshme të arbëreshëve: gjuhën dhe letërsinë.

¹ Martin Camaj në numrin përkujtimor të kushtuar Prof. Ernest Koliqit të botuar pas vdekjes së tij (1975) kështu shkruan: "Pjesën më të madhe Koliqi e kaloi në dhën e huej, në një anë gjithnjë në kontakt me botën shqiptare e sidomos arbëreshe, dhe në tjetrën si profesor universiteti e shkrimtar në dialog të përhershëm me rrethe intelektuale të ndryshme të botës perëndimore" (f. 8).

² Ja sa shkruan M. Camaj në artikullin "Udhëtim veruer nëpër Arbreshë të Kalabris": "ukMbas pesë vjetve jete të revistës "Shêjzat", takimet me intelektualët arbreshë, lavruesat të censhëm e puntorë entusiasta të gjuhës e letërsisë sonë, të bëjmë me prekje me dorë faktin se tradita kulturore e De Radës me shokë, këputë apo ndalue për një periudhë të gjatë, është ngjallë ndër ta dhe ka marrë vull zhvillimi. Gjatë tri javësh ditësh pjekjesh e bisedash me Arbreshët e Kalabris prof. Koliqi dhe unë mësuem sende me randësi në kontakt direkt me njerëz të gjakut tonë, të pajisur me një letërsi gojore të thellë, në të cilën fryzime të vjetra të shpirtit lindur e prandimur shkrihen në një për bukuri tue rrujtë përherë tiparet e lashta shqiptare" (Shêjzat, 1961, n. 7-8, f. 254).

³ "Tue u pasë kujtue me kohë se kjo landë e paçmueshme është në rrezik të humbi, janë marrë inicjativa nga Instituti i Studimeve shqiptare të Romës, mbrenda mundsisve që ky ka, që të mblidhet e gjithë tradita popullore e Arbreshëve t'Italis. Gjithkund ndër lokalitetet arbreshë gjinden njerëz që me entuzjazzëm mbledhin sistematikisht tash për tash prallat, një pjesë e vogël e të cilave të botuem në "Shêjzat", kanë ngjallë interesim në rrethet shkencore të botës prandimore" (*Ibidem*).

Interesat gjatë vizitave të Koliqit dhe të Camajt në komunitetet arbëreshe plotësohen. I pari, politikan dhe studiues, thotë që arbëreshët kanë nevojë për një mbrojtje ligjore të përshtatshme, brenda shtetit italian, që me Kushtetutë deklaron që mbrojnë të gjitha pakicat e pranishme në territorin italian, pse perfaqësojnë një thesar që nderon gjithë shtetin italian⁴; i dyti kalon në praktikë dhe me magnetofon regjistron materiale gjuhësore në katunde të ndryshme: në Barile, në Greci, në Villa Badessa, në Falconara, në S. Costantino Albanese⁵ etj.

⁴ Për të mbrojtur pakicën gjuhësore arbëreshe prof. Koliqi mendonte që ishte e nevojshme e drejta për mësimin e gjuhës dhe letërsisë shqipe në katundet arbëreshe. Kështu që, bashkë me kërkesën e një ligji të veçantë për mbrojtjen e të gjitha pakicave historike në territorin italian, ai shrytëzoi edhe mundësitë e ligjit të zakonshëm për të dhënë aftësinë e mësimin të gjuhës dhe letërsisë shqipe. Për këtë qëllim arriti të organizojë provime të përshtatshme me pranimin e autoriteteve të duhura, duke u nisur nga viti 1961: "Dal 14 al 18 febbraio c.a. (1961) si sono svolte a Cosenza nella sede del locale Istituto Magistrale, le prove scritte dell'Esame di abilitazione all'insegnamento della Lingua e Letteratura albanese nelle Scuole e negli Istituti di istruzione secondaria. Titolo valido per l'ammissione: la laurea in lettere e filosofia e quella in lingue conseguita in Istituti di rango universitario (Magistero, Istituto Superiore di Economia e Commercio di Venezia, Bocconi di Milano, Istituto Orientale di Napoli ecc.). I 7 candidati iscritti all'esame erano quasi tutti provenienti dalle comunità italo-albanesi (Molise, Calabria, Sicilia)" (Shëjzat, 1961, n. 1-2, f. 52).

⁵ Në përshkrimin e udhëtimit në katundet arbëreshe të vitit 1961, M. Camaj paralajmëron punën e përmbledhjes së letërsisë gojore dhe, duke u referuar, tregon si prof. Lukë Perrone nga fshati arbëresh i Ejaninës kish tashmë filluar të mbledhte prallat: "Nji sherbin të nadh po i bân folklorit shqiptar prof. Lukë Perrone nga Ejanina. Ky ka mbledhë afër dyqind pralla arbëreshe në katundet Ejaninë, Frasnitë, Çifti (Civita), Platan (Plataci); Kasternexhë (Castroregio) e Farnetë. Këto pralla do të dalin në një vëllim të posaçëm afër 300 faqesh, që do të jenë blemit i parë i një kolane traditash popullore nën kujdesin e drejtpërdrejtë të prof. Koliqit, i cili drejton metodikisht mbledhjen e kësaj lande" (*Ibidem*, f. 255). Përmbledhja e përrallave me kujdes të Luka Perrone u botua nën drejtimin e prof. Ernest Koliqit: *Novellistica italo-albanese*, <Tradizioni popolari degli Albanesi d'Italia>, Vol. I, Leo S. Olschki Editore, Firenze 1967; më vonë janë botuar dy vëllime të tjera: *Racconti popolari di S. Sofia d'Epiro* – S. Demetrio Corone – *Macchia Alb.* – S. Cosmo Alb. – *Vaccarizzo Alb.* – S. Giorgio Alba., <Tradizioni popolari degli Albanesi d'Italia, Vol. II>, Leo S. Olschki Editore, Firenze 1970; *Favole, fiabe, racconti di S. Nicola Dell'Alto* – *Carfizzi* – *Pallagorio* – *Marcedusa* – *Andali* – *Caraffa* – *Vena di Maida* – *Zangarona*, raccolti, trascritti e tradotti da Elio Miracco, Bulzoni Editore, Roma, 1985. M. Camaj ka botuar disa libra me përralla popullore arbëreshe dhe studime: *La parlata albanese di Greci in provincia di*

Shqyrtime për vëmendjen e Camajt ndaj kulturës arbëreshe

Ka qenë pikërisht studimi i varianteve kryesore arbëreshe, që ka një rëndësi më vete të jashtëzakonshme, që i ka dhënë mundësinë të vlerësonte edhe letërsinë arbëreshe.

Shikojmë tani shkurtimisht vetëm diçka për këto dy aspekte:

- 1) së pari për metodologjinë e studimit të varianteve arbëreshe
- 2) së dyti për rëndësinë që merr letërsia arbëreshe dhe për nevojën që të lexohet dhe të kuptohet në versionin origjinal.

1 - Studimi i varianteve arbëreshe

Duke u nisur nga hipoteza që variantet e të folmeve arbëreshe të Italisë mund të grumbullohen në 10 ose 12 tipare themelore, ai shpreh bindjen që nga pikëpamja metodologjike duhet të hartohet një monografi për çdo tipar. Kështu mund të kemi një model përshkrimi të plotë për çdo tipar, ku merret parasysh aspekti fonologjik dhe morfologjik, dhe ku futen edhe tekstet gojore të vjelura me kujdes pse janë baza dokumentare në të cilën mbështetet studimi. Në fund monografia mbaron me një glosar⁶.

Avellino, Leo S. Olschki Editore, Firenze 1971; *Racconti popolari di Greci (Katundi) in provincia di Avellino e di Barile (Barili) in provincia di Potenza*, <Tradizioni popolari degli Albanesi d'Italia, Vol. III>, Istituto di Studi Albanesi dell'Università di Roma, Roma 1972; *La parlata arbëreshe di San Costantino Albanese in provincia di Potenza*, Centro Editoriale Librario dell'Università della Calabria, Rende 1993. Në kohët e fundit është botuar postume një përmbledhje tjetër të Luka Perrone-s: *Racconti popolari dell'Arbëria crotonese / Përralla nga Arbëria e Kutronit (San Nicola dell'Alto / Shën Nikolli, Carfizzi / Karfici, Pallagorio / Puheriu)*, raccolti e trascritti da Luca Perrone, Centro Editoriale e Librario, Università della Calabria, Rende 2004.

⁶ Në kumtesën që M. Camaj mbajti në Kongresin Ndërkombëtar për Studimeve Shqiptare të mbajtur në Palermo më 25-26 Nëntor 1981 ai ka shprehur qartas këte planë pune. Mbasi është vështirë të gjindet vëllimi i Akteve citoj këtu poshtë drejtpërdrejt fjalët e Camajt: "Noi ci siamo decisi per tempo a fare la raccolta del materiale linguistico paese per paese e a compilare grammatiche a parte colla seguente disposizione: *parte introduttiva, fonologia, morfologia, testi e glossario*. E' lavoro di lunga durata, tuttavia sono ancora propenso a continuare con le monografie di questa struttura, giacché il procedere ad indagare sulle isoglosse arbëreshe tramite questionari di atlanti linguistici, non arriva allo scopo proposto, cioè di avere una classificazione esatta e definitiva. Ed ecco perché: a) qui in Italia Meridionale abbiamo isole linguistiche albanesi; ciascuna di queste parlate si è sviluppata in un diverso contatto dialettale italiano. Nel corso di questa trasformazione, oltre a ciò, sono subentrati anche fattori extralinguistici di cui si deve tener conto in una monografia; b) i questionari di isoglosse ovvero gli atlanti linguistici sono diretti ad individuare particolarità dialettali entro i confini di una

Camaj parapëlqen monografitë nga atlaset krahinore, pse monografitë na ofrojnë të dhëna të shumta dhe të dobishme për të sqaruar kontaktet dialektore midis arbërishtes dhe italishtes, përveç kësaj na ofrojnë të dhëna jashtgjuhësore, siç mund të jenë ato antropologjike, sociologjike dhe psikologjike.

Monografitë, në fund, lejojnë të krahasohen variantet arbëreshe të marra parasysh drejtpërdrejt:

- a) me të folmet e tjera arbëreshe dhe shqiptare;
- b) me format e gjuhës zyrtare të shkruar sot
- c) tërthorazi me dialektet italiane jugore.

Nga kjo pika e fundit rrjedh që mund të shpjegohen kontakte midis dialekteve, mund të përcaktohen rrugët e interferencave, si edhe pasojat e kontakteve midis të folmeve arbëreshe dhe të folmeve romance të Italisë jugore.

Qoftë atlaset krahinore, por në mënyrë më të kufizuar, qoftë monografitë, këto në mënyrë më shteruese, konkurojnë për të përcaktuar fazën arkaike e gjuhës shqipe të përbashkët.

Në veçanti pëcaktojnë zhvillimin diakronik dhe ndërtimin e toskërishtes së vjetër⁷.

2 – Studimi i Gramatikës shqipe

Një nga Gramatikat shqipe që kam studiuar me më shumë kujdes ka qenë *Albanian Grammar* të Camajt, të vitit 1984⁸, që përmirësonte

lingua, ma non le relazioni di tutti gli elementi linguistici tra loro: questa cognizione è un retaggio della linguistica strutturale le cui norme descrittive non devono essere sottovalutate; c) in una monografia dove si cerca anche di riallacciare le parti della grammatica l'una con l'altra, la fonologia con la morfologia e questa poi con la sintassi, trovano il loro posto anche le varianti che abbondano nelle parlate arbëreshe” (M. Camaj, *Per una tipologia dell'arbëresh*, in *Etnia albanese e minoranze linguistiche in Italia*. Atti del IX Congresso Internazionale di Studi Albanesi, Palermo 25-28 Novembre 1981, a cura di Antonino Guzzetta, Istituto di Lingua e Letteratura Albanese, Università di Palermo, Palermo 1983, f. 152.

⁷ Një ide shumë e vyer kjo e Camajt që synon të rindërtojë toskërishten e vjetër falë studimit të të folmeve arbëreshe: “Le cognizioni particolari che si possono recuperare in parte anche attraverso questionari di isoglosse e di atlanti linguistici ovvero dialettali e i dati sulla struttura interna risultante da monografie dettagliate sulle parlate italo-albanesi sono indispensabili: 1) per la ricostruzione di una fase arcaica dell'albanese comune, e in particolare; 2) per lo sviluppo *diacronico* e ricostruzione dell'antico toscano per il quale mancano estintichi” (*Ibidem*, f. 153).

Shqyrtime për vëmendjen e Camajt ndaj kulturës arbëreshe

versionin gjermanisht *Lehrbuch der albanischen Sprache*, të vitit 1969, dhe pak më vonë e përkthyer italisht (*Grammatica albanese*) nga Ardian Vehbiu në 1995, në atë kohë lektor i shqipes në Universitetin e Napolit L'Orientale⁹. Arsyeja e terheqjes së veçantë ka qenë, patjetër, hapësira që studiuesi i ka dhënë varianteve të gjuhës shqipe: së pari gegërishtes – gjuha e Camajt – pra toskërishtes, por edhe arbërishtes dhe gjuhës standarde. Për sa i përket varianteve, Autori merr parasysh, jo vetëm leksikun, por *elementet gramatikore, me qëllim që të kihet një pamje e strukturës-bazë të gjuhës*, e quajtur shqipe e përbashkët.

Së pari më ka lënë përshtypjen e një gramatike krahasuese, ku unë mund të ballafaqoja, gradualisht, format e arbërishtes që më ishin më të njohura, më të gjalla pse më të klimatizuara në kulturën time gjuhësore të folur, me format që kisha studiuar dhe lexuar në librat e dryshëm, qoftë në gjuhën standarde, qoftë në variantet geqe dhe toske¹⁰.

Mbasi Camaj, në këtë Gramatik shënon edhe evoluimin e disa formave, në perspektivën diakronike, nënvizon edhe lashtësinë e disa formave të arbërishtes duke i krahasuar me ato që gjinden në veprat e autorëve të parë të letërsisë.

Përkthimi italisht, që është botuar në Kosencë nga Botuesi Brenner, ka pasur sukses edhe pse kjo formë krahasimi u ka vënë në dritë arbëreshëve vlerën e të folmeve të ndryshme që ata përdorin zakonisht pa pasur ndërgjegjen e pasurimit të atij thesari gjuhësor.

Camaj ka kontribuar kështu, edhe ai, si në shekullin XIX Jeronim De Rada, dhe në shekullin XX Ernest Koliqi – mjafton të lexojmë *Këngët e Milosaos* dhe *Kangjelet e Rilindjes* – për t'u zgjuar ndërgjegja e arbëreshëve dhe t'u vlerësuar pasuria e gjuhës së tyre e pasuria e letërsisë.

Tani një shënim si kureshtje: në impostimin e trajtimit të elementeve të ndryshme të gramatikës dhe të varianteve gjuhësore, Camaj i kushton një vend të veçantë varianteve arbëreshe. Them të veçantë, me kuptim jo

⁸ Martin Camaj, *Albanian Grammar with Exercises, Chrestomathy and Glossaries*, Otto Harrassowitz, Wiesbaden, 1984

⁹ Martin Camaj, *Grammatica albanese con Esercizi, Crestomazia e Glossario*. Traduzione italiana di Ardian Vehbiu, Edizioni Brenner, 1995

¹⁰ E pohon edhe përkthyesi në *Parathënie* e botimit italian të kësaj Gramatike kur shkruan se: "Per la prima volta il lettore italiano troverà, all'interno di una stessa grammatica, paradigmi e forme dei tre dialetti principali dell'albanese: Ghego (Nord), Tosco (Sud) e Arbëresh (Italia Meridionale), la cui importanza trascende la sfera della lingua, estendendosi a quella della letteratura e, più in generale, della cultura albanese" (Martin Camaj, *Grammatica Albanese*, cit. f. 5).

medoemos “të rëndësishëm”. I dallon nga ana tipografike duke i futur pas varianteve gege dhe toske ose standarde; dhe kjo pozitë mund të interpretohet si një *diminutio* të rëndësisë së formave, por kështu nuk është, pse edhe përdorimi i germave më të vogla, dhe fjala “Shënim” me shkronja të zeza i dallon dhe i nënvizon.

Me duket që Camaj ka kapur dukuritë gjuhësore më të rëndësishme të arbërishtes, nga njëra anë duke u mbështetur në të folmet akoma të gjalla, por sidomos duke u mbështetur në veprat e autorëve.

Nga pikëpamja fonetike paraqet edhe allofonet, siç ndodh në Falconara Albanese, ku *l* (sonante anësore) shqiptohet si *q*; ose *h* (faringale e shurdhët) që në të folmet e katundeve, Shën Mitër, Shën Sofi, Makj, Vakaric, Strighar, dhe Mbuzat shqiptohet *gh* (shtegore prapagjuhore), siç gjëndet pra edhe në veprat e autorëve që lindën në ato katunde.

Camaj, pra, i vë mend edhe gjatësisë së zanoreve, që edhe sot, ka një funksion, ka vlerë dalluese, si del në formën *ũ* (*ũ* e shkurtër; shqip *unë*) në krahasim me *ū* (*ū* e gjatë; shqip *uri*).

Edhe në morfologji Camaj na vë në dukje trajtat më të vjetra që ruan arbërishtja: a) kallëzoren sekondare, me vlerë vendore, por jo në mënyrë ekskuzive, që del me mbaresën *-t* (*ndë malt*); dhe në shumës me *-shit* (*maleshit*) – që përputhet me të njëjta trajta që gjinden në *Mesharin* e *Buzukut*;

b) dy trajtat e gjinore-dhanore shumës me mbaresën *-e* dhe *ve* – dukuri që na tregon se futja e *-v* *-së* është më e vonë dhe gjindet midis dy zanoreve; p.sh. t. *i priftëre/ g. i priftëne* ndërsa *i udhëve*.

Mjaftojnë këta pak shembuj për të kuptuar pasurinë e të dhënave edhe nga pikëpamja e diakronisë së gjuhës. Nga ana tjetër duhet të pohojmë që ishte e nevojshme një gjë e tillë pse këto trajta, që kam cituar, Camaj i gjen në veprat e letërsisë arbëreshe, dhe nuk mund mos t’i mirrte parasysh.

Nga ky konstatim rrjedh që Camaj kur shkroi këtë Gramatik mbajti parasysh problematikën që paraqet leximi i letërsisë qoftë ajo arbëreshe, qoftë ajo gege, qoftë ajo toske, dhe në fund edhe ajo në gjuhën standarde.

Kjo lidhje me veprat e shkruara na lejon të ndalemi pak për të shqyrtuar atë që Camaj mendon për letërsinë e shkruar në variantin arbëresh. Më duket interesant ta nënvizojmë pse janë mendime dhe gjykime që dalin nga pena e një gjuhëtari dhe njëkohësisht nga pena e një poeti, me ndjeshmëri të veçantë.

3 – Gjykime për letërsinë arbëreshe

Pohimi i Camajt: *Letërsia shqipe pa kontributin e arbëreshëve nuk do të ishte ajo që është* na shtyn të studiojmë vlerat artistike të veprave të

Shqyrtime për vëmendjen e Camajt ndaj kulturës arbëreshe

ndryshme të letërsisë së shkruar në variantet arbëreshe, si edhe pasurinë e motiveve që përsëriten në këtë letërsi¹¹.

Për të përcaktuar vlerat estetike mjafton një shikim i shkurtër vargut, të lirë nga rima, të veprës së De Radës *Këngët e Milosaos*, për të rrokur fuqinë shprehëse dhe atë që Jakobsoni quan si largim nga ligjërimi i zakonshëm. Vargu i Milosaos përmban edhe një farë moderniteti të jashtëzakonshëm që lidhet edhe me trajtimin e përmbajtjes, që paraqitet jashtë normave të *fabulës*, ku spikat sekuenca e imazheve në vend të rrëfimit të shkallëzuar dhe të plotë¹².

Nga ana tjetër pasuria e motiveve të pranishme në letërsinë arbëreshe e dallon këtë dhe e cilëson si letërsi me një zhvillim të pareshtur dhe të rregullt, edhe kur marrim parasysh kalimet nga një periudhë në tjetër, ku mund të shënojmë edhe lidhjet me rrymat letrare italiane dhe europiane.

Janë mendimet e Camajt i cili, me një studim të shkurtër të lexuar në takimet shkencore të mbajtura në Sicili në vitin '85, terheq vëmendjen e arbëreshëve duke u thënë të çmojnë letërsinë e tyre, dhe ta lexojnë me vëmendje pse ka vlera artistike të larta, paraqitet me motive origjinale që shpesh sintetizojnë përvojat e tri botëve kulturore: atë arbëreshe, atë shqiptare dhe atë italiane. Dhe citonte veprën e larmishme dhe komplekse

¹¹ Martin Camaj rrok, së pari, dy aspektet interesante të kontributit të letërsisë arbëreshe ne quadrin e historisë së letërsisë shqiptare ne përgjithësi: “Avverto subito che la scelta dei dati è fatta non tanto per mettere in rilievo meriti e doti speciali dei singoli autori, quanto fatti attestanti che la letteratura albanese senza il contributo degli italo albanesi non sarebbe quella che è, né per quanto riguarda il valore artistico, né per ricchezza di motivi. Inoltre alla letteratura arbëreshe spetta la prerogativa, rispetto a quella dell’Albania, di aver avuto uno sviluppo abbastanza regolare per quanto riguarda i passaggi da un periodo all’altra, allacciandosi così alle correnti letterarie europee” (Martin Camaj, *La letteratura arbëreshe nel quadro generale della letteratura albanese*, in *Le minoranze etniche e linguistiche*. Atti del 1° Congresso Internazionale, Palermo-Piana degli Albanesi 4/7 Dicembre 1985, f. 201).

¹² Kritiku Giuseppe Gradilone duke analizuar “*I Canti di Milosao*” për të vënur në pah vlerat artistike të kësaj vepre themelore të letërsisë arbëreshe sintetikisht shkruan: “Per concludere, i *Canti di Milosao* sono pagine poetiche, espressioni di particolari stati d’animo, ed è inutile quindi volere in essi l’unità e l’organicità che è di altri generi letterari, quali l’epica e il romanzo: l’unità va cercata in ogni singolo canto e in ciascuna immagine in sé conchiusa e densa di vita poetica. La migliore delle letture quindi è quella episodica, che trascuri trama e sviluppo di azione, per concentrarsi tutta nel godimento della poesia” (Giuseppe Gradilone, *I <Canti di Milosao> di Girolamo De Rada. Genesi e frammentismo*, in *Studi di letteratura albanese*, Urbinati Editore, Roma, 1960, f. 17).

të Zef Skiroit, e cila mund të konsiderohet si kulmi i një letërsie që, nga pikëpamja kulturore, perfaqon tri realitete të ndryshme, por me lidhje dhe interferenza të ndërsjella¹³.

Me ndjeshmërinë e tij, si poetë, Camaj arrin të japë elemente dallimi për vlerat artistike. Ai me shumë hollësi dhe mbrehtësi gjen “poezinë e vërtetë” në këngët e veprës *Gjella e Shën Mërisë Virgjër* të Jul Varibobës, ku flatron një frymë e re, dhe jo në këngët, p.sh. të Budit, të cilat, njësoj me ato të Varibobës, kanë modelet në këngët fetare liturgjike.

Kënga e ripunuar e Varibobës *tingëllon si këngë krejt originale, me freskinë poetike e një kënge popullore*¹⁴. Mund të themi që në poezinë e Varibobës gjejmë zanafillën e poezisë arbëreshe dhe shqipe të shekullit XIX, të rrymës së romantizmit, kur vepra mbështetet në letërsinë popullore nga e cila merr frymën, fuqinë poetike, qëndrueshmërinë dhe paraqitet si diçka të re dhe originale, siç ndodh për *Këngët e Milosaos* të De Radës.

Më duket e dobishme të citoj gjykimin e Camajt kur ai shkruan se *Variboba duhet të konsiderohet si një nga poetët lirikë më të mëdhenj të letërsisë shqipe*¹⁵.

¹³ Duke u referuar veprës *Këthimi*, Camaj sintetizon konceptin me këto fjalë: “*Këthimi* ha inoltre il merito di essere anche una documentazione linguistica in quanto il poeta di Piana in essa riesce ad amalgamare una lingua *standard*, arbëresh-albanese di madrepatria, come sostiene Giuseppe Schirò jr. ‘la più interdendale di ogni altra della letteratura albanese’ (Madi Mbusati e di Vascia Kanadë, rtin Camaj, *La letteratura arbëreshe nel quadro generale della letteratura arbëreshe* cit., f. 208).

¹⁴ Lidhjet midis këngëve originale dhe atyre të ripunuara Camaj i analizon dhe i lidh edhe me ripunimet e autorëve të tjerë shqiptarë, duke i dalluar në vlerat artistike që i karakterizojnë: “E’ da menzionare il fatto che in *Gjella* trovansi anche canti liturgici come nelle opere degli autori gheghi tra cui Budi, pure in rima, come *Stabat Mater*; la differenza però è cospicua in quanto che *Shën Mëria ruan t’biir* ‘S. Maria guardava il figlio’ suona come canto del tutto originale, con la freschezza poetica di un canto popolare, con tratti di una tragica rapsodia, in forma alterata anche oggi viene recitata a memoria in molti paesi arbëreshë, specie durante la Settimana Santa, ovunque con la cadenza recitativa di un *vajtim*, canto funebre” (*Ibidem*, f. 204).

¹⁵ Vazhdon me këto fjalë mendimi i Camajt: “*Gjella e Shën Mërisë Virgjër* ‘La vita di S. Maria Vergine’, come prima opera originale della letteratura arbëreshe, si contrappone solo dal punto di vista cronologico al *Cuneus Prophetarum*; anche se tutte e due di contenuto religioso, hanno poco o niente in comune, sia nella forma e nella mole che nell’intento. Di essenziale rimane peraltro il fatto che il Bogdani non è un poeta, mentre Variboba, a mio avviso, è da ritenere come uno dei più grandi lirici della letteratura albanese” (*Ibidem*, f. 203).

Shqyrtime për vëmendjen e Camajt ndaj kulturës arbëreshe

Nga ana tjetër edhe De Rada, në antologjinë e vet, megjithëse e kritikon për fjalët e shumta të hazuara nga italishtja, në fund mbaron duke thënë që *Variboba është poet i lindur*¹⁶.

¹⁶ Jeronim De Rada nuk i fali Varibobës faktin që ky, megjithse poet i frymëzuar dhe me shumë aftësi poetike, nuk e ka pastruar gjuhën nga italianizmat dhe nuk e ka ruajtur me kujdes ritin e etërve që e kishin sjellë nga lindja në kohën e emigracioneve në shekullin XV. Njëkohësisht, thotë De Rada se Variboba ka futur në veprën e vet këngë popullore të traditës kalabreze ose në përgjithësi të Italisë së Jugut, së bashku me rimat dhe metrat e poezisë italiane. Tepër i rreptë është gjykimi i De Radës ndaj veprës së Varibobës dhe mund të pohojmë që është një gjykim i diktuar më shumë nga ndjenja patriotike që ngrohte zemrën e De Radës, se sa nga kthjelltësia dhe nga paanshmëria e vlerësimit të artit poetik. Citojmë gjithë copën që De Rada futi në një shënim të “Antologia Albanese” të vitit 1896: “Giulio Variboba, figlio dell’Arciprete *pro tempore* di Mbusati e di Vascia Kanadè, fu uno de’ primi alunni del Collegio albanese in S. Benedetto Ullano; e reminiscenze classiche, specialmente di Ovidio, si succedono nel suo poema. Il quadro ch’ei presenta è di una realtà insuperabile, ma di sorti abbiette e ignare di patria. Egli stesso, poeta nato, non ha un pensiero né in religione né in altro che lo sollevi sopra il volgo circueante ed onorante la casa di lui; e nel quale e’ si compiacque sino ad accoglierne la favella invasa dalla lingua d’Italia dove senza scuola stava esule da tre secoli. E la sua popolarità procuratagli dall’adeguarsi al volgo e dalla introduzione della rima e de’ metri allora in voga nell’Italia, nocque assolutamente alla tradizione poetica. Ogni anno a Pasqua uno dei villaggi di questo e quel cantone albanese, vestiti del prisco abito patrio visitavano le dimore vicine de’ connazionali cantando le Rapsodie del comune paese perduto: queste visite dette di *Rusalle* ospitate per settimane nelle case fraterne mantenevano la patria. Or dell’alte antiche memorie presero il luogo le nuove cantilene sue dakll’idea ammeschinata e sino profana, come da chi non capisce. Sicchè ebbe testè il dotto e arguto critico, Alberto Stratigò da Lungro, a ravvicinarlo allo scimunito prete da Aprigliano *Tonnu Pantu*. Non vogliamo protrarre oltre la profanazione, inescusabile dalla rozzezza o dalla semplicità dell’intento, e la quale offese molti animi schivi ed austeramente gravi. Già non vuolsi altro per giudicare se il contenuto e la forma di tale poesia le meriti la dichiarazione di *classica sopra ogni altra* appresso l’autorità estetica dell’illustre Gustavo Mayer.

Poniam fine a questo cenno con un aneddoto caratteristico. Uno dei primi alunni del Collegio albanese fu un adolescente della mia Makji. Gian Francesco de’ Conti Avato, del cui straordinario ingegno fa, nella sua storia dello stabilimento del Collegio, menzione speciale il Zavarrone. A noi è pervenuta vergata di sua mano la prima raccolta preziosissima di Rapsodie popolari, importate con noi dalla Madre Patria. Succeduto al Rodotà nella presidenza del Collegio il Vescovo Archiopoli di S. Demetrio assunse alla Cattedra di umanità Avati; e commise gli

(Më lejoni tani një divagacion, një ndërshtënie të shkurtër, ose një njoftim: pikërisht në këto ditë ka dalë nga shtypi, këtu në Tiranë, botimi i dytë i *Gjellës së Shën Mërisë Virgjër*, me tekstin origjinal dhe me shënime shqaruese, së bashku me një glosar (për të lehtësuar leximin e tekstit arbërisht), që kam hartuar unë për Sht. B. Toena, dhe që futet në serinë “Visare të Letërsisë Shqiptare” të drejtuar nga Profesorët Rexhep Qosja dhe Jorgo Buló¹⁷).

Vazhdojmë me mendimet dhe gjykimet e Camajt.

Poeti Camaj, si edhe studiuesi i varianteve arbëreshe, ka lexuar të gjitha veprat arbëreshe, por Autori që i pëlqeu më shumë është patjetër Jeronim De Rada, sepse në krahasim me autorë të tjerë është poet i vërtetë dhe i plotë.

Camaj pohon me siguri se data e botimit të parë të veprës *Këngët e Milosaos*, d.m.th. 1836, mund të konsiderohet si fillimi i periudhës, ose i

pur l'Ufficio di Rettore. Ma mutò affetto dopo qualche anno il Vescovo ch'eragli pur affine, e trattò segretamente a sostituirgli nel Rettorato Variboba. Or al primo dì di Novembre, Avati che 'l sapeva, si recò al suo posto a ricever gli alunni. Dopo la settimana, veduto giungere Variboba, lo aspettò in capo alla scala, e l'interpellò col motto di Cristo a Giuda: *Amice ad quid venisti?* E si mise giù per la scala dritto all'abitazione d'un mulattiere, con cui al mattino seguente partì diretto a Roma. Donde passò ad una cattedra nel Collegio di Urbino. Ivi morì dopo il 1800” (Appendice alla Grammatica. *Antologia Albanese tradotta fedelmente in italiano da Girolamo De Rada*, Napoli, Stab. Tipo-Stereotipo del Cav. A. Morano, 1896, f. 59, shënim 1).

¹⁷ Jul Variboba, *Vepra - Gjella e Shën Mërisë Virgjër*, Përgatitur nga Prof. Italo Costante Fortino, “Visare të Letërsisë Shqiptare”, Botimet Toena, Tiranë 2010. Ja sa shkruan Akademiku Jorgo Buló për këtë botim të Tiranës së lartëpërmendur: “Jul Variboba është një dukuri e re në letërsinë arbëreshe, në kulturën shqiptare dhe në kulturën kristiane të shqiptarëve. Vepra e tij mbyllte një epokë dhe shtronte udhën drejt një epoke tjetër në historinë e letërsisë shqipe, shënonte një thyerje dhe, në të njëjtën kohë, një vazhdimësi në procesin e formimit të letërsisë kulte, mohonte diçka nga tradita e mëparshme dhe pohonte gjithçka nga fryma e saj kristiane e humane, flakte lëvizshmëri dhe saj didaskalike dhe kultivonte bërthamën e sopirti e të virtytit njerëzor kristian. Ajo u bë kështu një urë kalimi nga letërsia fetare, utilitare, në letërsinë reflektuese, që niset nga dogma për t'i dhënë asaj interpretimin artistik të përjetimit emocional, subjektiv të thelbit të saj hyjnore e njerëzore. Ajo nuk është as një katekizëm, as një diskurs teologjik a epos religjioz për historinë e shenjtë, por është një diskurs artistik për dashurinë dhe dhimbjen njerëzore, për metaforën e misterit të mëmësisë virgjërore” (4^a e kapakut të veprës Jul Variboba, *Vepra - Gjella e Shën Mërisë Virgjër* të cit.).

Shqyrtime për vëmendjen e Camajt ndaj kulturës arbëreshe

fazës së letërsisë së *Rilindjes kombëtare shqiptare*, dhe se kjo vepër është një nga më të qëlluarat e letërsisë shqipe me një funksion patriotik të jashtëzakonshëm.

Pra Camaj vazhdon ture treguar se vepra e De Radës përmban cilësi estetike dhe tematike, me vlera njerëzore universale¹⁸.

Një shembull: koncepti i heroit ndryshon nga ai klasik i letërsisë shqiptare. Në veprën e De Radës heroi është një figurë e pajisur jo vetëm me vlera ushtarake dhe me aftësi të rralla, por edhe me ndjeshmëri, me njerëzim për të cilën ky heroi deradian transmeton njëfarë melankolie romantike, si edhe njëfarë nënstrimi njerëzor.

Të ndryshëm janë kreshnikët, që paraqiten të ashpër dhe të pamëshirshëm, si janë të përshkruar dhe të lartësuar në veprën *Lahuta e Malcis*. Camaj përfundon duke pohuar që heroi i De Radës nuk do të bëhet kurrë anakronik, si rrezikon të bëhet heroi i Fishtës¹⁹.

4. Përfundim

Këto mendime të Martin Camajt për gjuhën dhe letërsinë arbëreshe na shtyjnë të bëjmë disa vërejtje.

Është një mrekulli e jashtëzakonshme që edhe sot ekzistojnë të folme të gjalla arbëreshe me variante të ndryshme. Ato i rezistojnë kohës, por, si na thotë Camaj, sot janë e venë duke u zhdukur për arsye të pamëshirshme.

¹⁸ M. Camaj e shpreh me bindje këtë mendim dhe këtë gjykim që vlerëson plotësisht veprën e De Radës si një nga më të përsosura dhe më të naltë të letërsisë shqiptare: “Comunque sia, la prima edizione del poema *Milosao* del 1836 segna peraltro una data memorabile nella divisione in periodi della letteratura albanese, cioè l’inizio dell’era, detta *Rilindja* (Rinascita nazionale dell’Albania) per cui la critica letteraria, sia in madrepatria che fuori, sta mettendo in rilievo con insistenza la funzionalità patriottica di quest’opera, per fortuna una delle migliori di tutta la letteratura albanese! Ci conforta però anche un altro fatto, importante per la valorizzazione del De Rada, che le nuove generazioni stanno scoprendo altre qualità estetiche e contenutistiche nella creazione del sommo poeta, qualità di valori universali” (M. Camaj, *La letteratura arbëreshe nel quadro generale della letteratura albanese*, cit., f. 206).

¹⁹ “Nei personaggi eroici, come *Milosao*, riscontriamo compatibilità di valore militare e bravura misti alla sensibilità per cui il condottiero albanese deradiano ispira melanconia romantica e qualche volta senso di umana rassegnazione; caratteristiche queste per niente affini agli eroi dei confini, detti *kreshnikë*, rudi e inesorabili dei canti epici delle Alpi albanesi, esaltati pure nell’opera del Fishta. Invero, nel processo di cambiamento del gusto presso le nuove generazioni, si dovrà sempre calcolare che l’eroe deradiano non diventerà mai anacronistico come corre pericolo che diventi quello del Fishta ed altri” (*Ibidem*, f. 206).

Nga këtu rrjedh nevoja e dokumentimit me shkrim për t'i ruajtur për gjithmonë.

Siç dimi, letërsia shqipe vetëm në 60 vitet e fundit është shkruar në gjuhën standarde, gjuhë zyrtare e botës shqiptare.

Por veprat e letërsisë të shekujve më parë janë shkruar gegërisht, toskërisht dhe arbërisht. Këtu duhet të shtojmë që edhe pas viteve '50 të shekullit të kaluar disa autorë kanë vazhduar të shkruajnë në variante të ndryshme.

Mjafton të citojmë veprat e Camajt dhe ato të Koliqit, si edhe shumicën e veprave arbëreshe.

Një nevojë shkakton nga këto mendime të Camajt: që edhe sot, ndoshta sidomos sot, për të lexuar veprat e letërsisë shqiptare dhe arbëreshe, duket të njohim variantet e gjuhës shqipe dhe arbëreshe në të cilat është shkruar letërsia.

Kështu që nuk do të kemi më nevojë të prekim ose të cenojmë gjuhën origjinale të një autori, dhe ta përshtatim në gjuhën e sotme standarde.

Camaj na sugjeron të behemi të aftë të lexojmë, dhe të çmojmë, veprat e letërsisë pan-shqiptare në variantet origjinale, d.m.th. në formën që ka dalë nga mendja e autorit.